REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA - VLADA - GOVERMENT
MINISTRIA E EKONOMISË
MINISTARSTVO EKONOMIJE
MINISTRY OF ECONOMY

| | | | |
|---|---|---|---|
| Njesia Org. Org. Jedin Org Unit | 0113 | Nr. Prot. Br. Prot Prot.No: | 194 |
| Nr. i faqeve Broj stranica No. pages | / | Data: Datum: Date: | 09.02.25 |

PRISHTINË/A

N.H. V.P. „IBËR-LEPENC" SH.A. D.D.
01-369 Dt. 09-02-2026
PRISHTINË-PRIŠTINA

NDËRMARRJA HIDROEKONOMIKE "IBËR - LEPENC" SH.A.

HYDRO - ECONOMIC ENTERPRISE "IBËR - LEPENC" J.S.C.

VODOPRIVREDNO PREDUZEĆE "IBËR - LEPENC" D.D.

Sheshi "Bill Klinton" Nr.13 Prishtinë, Kosovë Bulevardi "Bill Klinton" Br.13 Priština, Kosovo
Tel: 038/226-070, 225-006, Fax: 038/226-159; Email: info@ iber-lepenc.org

# Raporti për vlerësimin e rreziqeve për periudhen tre mujore Tetor -Dhjetor (TM4)2025

Bordi i Drejtorëve në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë 09.02.2026 pas shqyrtimit të Raportit për vlerësimin e rreziqeve për periudhen tre mujore Tetor-Dhjetor (TM4)2025,mori vendim për miratimin e këtij raporti dhe kërkoi që i njëjti të përcillet në NJPMNP.

| | Delegoi | Aprovoi |
|---|---|---|
| Emri Mbiemri | Kryeshefi Ekzekutiv: | Kryesuesi i BD: |
| Nënshkrimi | Faruk Mujka | Bajram Mustafa |
| Data: 09.02.2026 | | |

Ndërmarrja Hidroekonomike "IBËR-LEPENC" sh.a. Vodoprivredno preduzeće d.d. Prishtinë-Priština

NDËRMARRJA HIDROEKONOMIKE **"IBËR - LEPENC"** SH.A.

HYDRO - ECONOMIC ENTERPRISE **"IBËR - LEPENC"** J.S.C.

VODOPRIVREDNO PREDUZEĆE **"IBËR - LEPENC"** D.D.

# Raport për Menaxhimin e Rreziqeve për vitin 2025

Ndërmarrja Publike "Ibër Lepenci" Sh.A., ofronë treg shitjen e energjisë elektrike, ujit të papërpunuar me shumicë dhe ujitjen, Shitjen e këtyre produkteve Ndërmarrja e ka të rregulluar veprimtarinë sipas legjislacionit dhe politikave të aplikueshme në Republikën e Kosovës. Përkundër rregullave të definuara për ofrimin e këtyre produkteve, gjatë ushtrimit të veprimtarisë, "Ibër Lepenci" Sh.A., ballafaqohet me rreziqe të natyrave të ndryshme, të cilat paraqesin pengesë në arritjen e objektivave të parapara në Planin e Biznesit.

Me Planin vjetor të Biznesit, "Ibër Lepenci" i ka të definuara Misionin, Vizionin dhe Objektivat, për çka edhe ekziston, por njëkohësisht angazhimin e vet e bën po ashtu për të ofruar produkte cilësore sipas mundësive, për të siguruar mbrojtjen e shëndetit të punëtorëve në punë dhe furnizimin e rregullt të kleintëve me produktet e tij. Duke pasur parasysh rëndësinë e angazhimeve të përmendura dhe pengesat të cilat mund të shfaqen e që shkaktojnë rreziqe, "Ibër Lepenci" -i ka ndërmarrë një sërë veprimesh të caktuara, të cilat kanë pasur për qëllim kryesor parandalimin dhe evitimin e tyre. Veprimet e ndërmarra kanë për qëllim funksionimin normal dhe avancimin e kualitetit dhe cilësisë së veprimtarisë. Duke pasur parasysh rëndësinë e identifikimit të rreziqeve dhe rëndësinë e ndërmarrjes së veprimeve të qëlluara me kohë, "Ibër Lepenci", ndër veprimet kryesore që i ka ndërmarrë, ka përfshirë identifikimin dhe parandalimin e këtyre rreziqeve gjatë tërë ciklit të zhvillimit të veprimtarisë.

Në tabelën në vijim janë përshkruar të gjitha rreziqet e identifikuara, si dhe plani për menaxhimin e tyre:

| **Lista e Rreziqeve 2025** | |
|---|---|
| 1 | Dalja në tregun e hapur të blerjes së energjisë elektrike ka rritur shpenzimet posaçërisht gjatë sezonës së ujitjes kur përdo rimi i pompave për shpërndarjen e ujit është më i madh; |
| 2 | Teknologjia e vjetër në hidrocentral; |
| 3 | Fatkeqësitë natyrore (reshjet e mëdha, rrëshqitjet e tokës, tërmetet, vërshimet etj.) mund të ndikojnë në dëmtimin e aseteve të ndërmarrjes |
| 4 | Thatësia ekstreme mund të rrezikojë realizimin e gjenerimit të planifikuar të energjisë elektrike si dhe distribuimin e ujit; |
| 5 | Shpenzimet e larta në sektorin e ujitjes si pasojë e vjetërsimit të hidrosistemit; |
| 6 | Dëmtimi i kanaleve të ujitjes, rrjedhja e ujit dhe shpërthimi i gypave nëntokësorë, të cilat mund të shkaktojnë dëme në pronat përreth. Ndërmarrja ka disa lëndë në proces gjyqësor dhe në disa prej tyre Gjykata e Shkallës së Parë ka vendosur në favor të palës paditëse, ndërsa lëndët aktualisht ndodhen në Gjykatën e Apelit pas ankesës së ushtruar nga Ndërmarrja. |
| 7 | Ekzistojnë disa raste ku operatorët ekonomikë nuk e kanë përmbushur kontratën, për të cilat aktualisht jemi në procese gjyqësore. Po ashtu, ekziston një rast gjyqësor nga operatori për shitjen e energjisë, i cili pretendon se Ndërmarrja nuk e ka përmbushur kontratën në aspektin e liferimit të sasive të energjisë. |
| 8 | Probleme te trasheguara me pronat e ndermarrjes të cilat nuk jane te evidentuar ne kadaster sipas aktvendimeve te shpronesimeve, ne nje rast jemi edhe ne proces gjyqesor; |
| 9 | Probleme te trasheguara lidhur me uzurpmin e pronave te ndermarrjes per te cilat raste sipas identifikimeve nga komisionet jane inicuar procedura gjyqesore. Ne disa raste lendet jane me aktgjykim te formes se prere e disa raste jane procese; |
| 10 | Një klient me të cilin kemi marrëveshje për pagesë të borxhit të prapambetur që ka ndaj nesh, po ka vështirësi financiare në zbatimin e marrëveshjes sipas afateve. |
| 11 | Kontesti i rastit gjyqësor me operatorin që IL ka pasur kontratë për shitjen e energjisë elektrike mund të rrezikoj likuiditetin. |

# MATRICA E RREZIQEVE

| Nr. | Lista e Rreziqeve 2025 | Mundësia | Ndikimi | Përshkrimi i veprimeve të ndërmarra / Arsyeja e pazbatimit | Dëshmitë mbështetëse (referenca dokumenteve) | Plani i veprimit për zbatim të mëtejmë (nëse aplikohet) |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Dalja në tregun e hapur të blerjes së energjisë elektrike ka rritur shpenzimet posaçërisht gjatë sezonës së ujitjes kur përdorimi i pompave për shpërndarjen e ujit është më i madh; | ☒ Sipas të gjitha gjasave<br>☐ I mundshëm<br>☐ Mesatar<br>☐ Vështirë se<br>☐ Rrallë | ☐ Serioz / Fatal<br>☐ Madhor<br>☒ Mesatar<br>☐ I vogël<br>☐ I Papërfillshëm | Përdorimi i pompave në kohën kur çmimi i energjisë është më i ultë | N/A | Përdorimi i pompave në kohën kur çmimi i energjisë është më i ultë |
| 2 | Teknologjia e vjetër në hidrocentral; | ☐ Sipas të gjitha gjasave<br>☒ I mundshëm<br>☐ Mesatar<br>☐ Vështirë se<br>☐ Rrallë | ☐ Serioz / Fatal<br>☒ Madhor<br>☐ Mesatar<br>☐ I vogël<br>☐ I Papërfillshëm | | N/A | N/A |
| 3 | Fatkeqësitë natyrore (reshjet e mëdha, rrëshqitjet e tokës, tërmetet, vërshimet etj.) mund të ndikojnë në dëmtimin e aseteve të ndërmarrjes | ☐ Sipas të gjitha gjasave<br>☐ I mundshëm<br>☒ Mesatar<br>☐ Vështirë se<br>☐ Rrallë | ☐ Serioz / Fatal<br>☒ Madhor<br>☐ Mesatar<br>☐ I vogël<br>☐ I Papërfillshëm | Ndikim i jashtëm me rrezik të brendshëm | N/A | Përpilimi i planeve të Emergjencave së bashku me AME dhe MPB |
| 4 | Thatësia ekstreme mund të rrezikojë | ☐ Sipas të gjitha gjasave<br>☐ I mundshëm<br>☒ Mesatar | ☐ Serioz / Fatal<br>☒ Madhor<br>☐ Mesatar | Ndikim i jashtëm me rrezik të brendshëm | N/A | Prioretizimi i nevojave të klientëve për ujë me shumicë - |

| Nr. | Lista e Rreziqeve 2025 | Mundësia | Ndikimi | Përshkrimi i veprimeve të ndërmarra / Arsyeja e pazbatimit | Dëshmitë mbështetëse (referenca dokumenteve) | Plani i veprimit për zbatim të mëtejmë (nëse aplikohet) |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | realizimin e gjenerimit të planifikuar të energjisë elektrike si dhe distribuimin e ujit; | ☐ Vështirë se<br>☐ Rrallë | ☐ I vogël<br>☐ I Papërfillshëm | | | KRU & KEK, me sasinë e domosdoshme. |
| 5 | Shpenzimet e larta në sektorin e ujitjes si pasojë e vjetërsimit të hidrosistemit; | ☐ Sipas të gjitha gjasave<br>☒ I mundshëm<br>☒ Mesatar<br>☐ Vështirë se<br>☐ Rrallë | ☐ Serioz / Fatal<br>☐ Madhor<br>☒ Mesatar<br>☐ I vogël<br>☐ I Papërfillshëm | Jemi duke e hartuar studimin e fizibiletetit për zëvendësimin e rrjetit të ujësjellësit. | N/A | Zëvendësimi i rrjetit të ujësjellësit. |
| 6 | Dëmtimi i kanaleve të ujitjes, rrjedhja e ujit dhe shpërthimi i gypave nëntokësorë, të cilat mund të shkaktojnë dëme në pronat përreth. | ☒ Sipas të gjitha gjasave<br>☐ I mundshëm<br>☐ Mesatar<br>☐ Vështirë se<br>☐ Rrallë | ☐ Serioz / Fatal<br>☐ Madhor<br>☒ Mesatar<br>☐ I vogël<br>☐ I Papërfillshëm | Ndërmarrja ka disa lëndë në proces gjyqësor dhe në disa prej tyre Gjykata e Shkallës së Parë ka vendosur në favor të palës paditëse, ndërsa lëndët aktualisht ndodhen në Gjykatën e Apelit pas ankesës së ushtruar nga Ndërmarrja. | N/A | Vazhdim i inicimit të procedurave gjyqësore për të gjithë abuzuesit. |
| 7 | Ekzistojnë disa raste ku operatorët ekonomikë nuk e kanë përmbushur kontratën, për të cilat aktualisht jemi në procese gjyqësore. Po ashtu, ekziston një rast gjyqësor nga operatori për shitjen | ☐ Sipas të gjitha gjasave<br>☐ I mundshëm<br>☒ Mesatar<br>☐ Vështirë se<br>☐ Rrallë | ☐ Serioz / Fatal<br>☐ Madhor<br>☒ Mesatar<br>☐ I vogël<br>☐ I Papërfillshëm | Është angazhuar një kompani konsulente e shërbimeve juridike për të na mbrojtur në rastin gjyqësor ku IL është palë e akuzuar | Kontrata e nënshkruar | -Menaxhimi i kontratave të bëhet në përputhje me rregullat, legjislacionin dhe kushtet kontraktuale.<br>-Ndjekja me kujdes e garancioneve, dinamikës së punëve, kuantitetit dhe kualitetit.<br>-Bashkëpunim i ngushtë i akterëve të përfshirë me përfaqësuesit ligjor për të |

| Nr. | Lista e Rreziqeve 2025 | Mundësia | Ndikimi | Përshkrimi i veprimeve të ndërmarra / Arsyeja e pazbatimit | Dëshmitë mbështetëse (referenca dokumenteve) | Plani i veprimit për zbatim të mëtejmë (nëse aplikohet) |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | e energjisë, i cili pretendon se Ndërmarrja nuk e ka përmbushur kontratën në aspektin e liferimit të sasive të energjisë. | | | | | siguruar mbrojtje efektive në procedurat gjyqësore. |
| 8 | Probleme te trasheguara me pronat e ndermarrjes të cilat nuk jane te evidentuar ne kadaster sipas aktvendimeve te shpronesimeve, ne nje rast jemi edhe ne proces gjyqesor | ☐ Sipas të gjitha gjasave<br>☒ I mundshëm<br>☐ Mesatar<br>☐ Vështirë se<br>☐ Rrallë | ☐ Serioz / Fatal<br>☐ Madhor<br>☒ Mesatar<br>☐ I vogël<br>☐ I Papërfillshëm | Është paguar qasja në Agjencinë kadastrale për të verifikuar pronat e IL | N/A | Evidentim i sakte i pronave dhe bashkepunim me kadastrat e komunave perkates dhe Agjencionin kadastral. |
| 9 | Probleme te trasheguara lidhur me uzurpmin e pronave te ndermarrjes per te cilat raste sipas identifikimeve nga komisionet jane inicuar procedura gjyqesore. Ne disa raste lendet jane me | ☐ Sipas të gjitha gjasave<br>☒ I mundshëm<br>☐ Mesatar<br>☐ Vështirë se<br>☐ Rrallë | ☐ Serioz / Fatal<br>☐ Madhor<br>☒ Mesatar<br>☐ I vogël<br>☐ I Papërfillshëm | Raportim i rasteve ne menyre urgjente te inspektoriatet e komunave perkatese<br>-Identifikim i te gjitha pronave te uzurpuara nga personat pergjegjes te ndermarrjes<br>-Kerkesa per inicim te procedurave per lirim te pronave tashme te uzurpuara | N/A | -Raportim i rasteve ne menyre urgjente te inspektoriatet e komunave perkatese<br>-Identifikim i te gjitha pronave te uzurpuara nga personat pergjegjes te ndermarrjes<br>-Kerkesa per inicim te procedurave per lirim te pronave tashme te uzurpuara |

| Nr. | Lista e Rreziqeve 2025 | Mundësia | Ndikimi | Përshkrimi i veprimeve të ndërmarra / Arsyeja e pazbatimit | Dëshmitë mbështetëse (referenca dokumenteve) | Plani i veprimit për zbatim të mëtejmë (nëse aplikohet) |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | aktgjykim te formes se prere e disa raste jane procese; | | | | | |
| 10 | Një klient me të cilin kemi marrëveshje për pagesë të borxhit të prapambetur që ka ndaj nesh, po ka vështirësi financiare në zbatimin e marrëveshjes sipas afateve. | ☐ Sipas të gjitha gjasave<br>☒ I mundshëm<br>☐ Mesatar<br>☐ Vështirë se<br>☐ Rrallë | ☐ Serioz / Fatal<br>☐ Madhor<br>☒ Mesatar<br>☐ I vogël<br>☐ I Papërfillshëm | Kemi nënskruar marrëveshje | N/A | Monitorim i vazhdueshëm;<br>Inicim i procedurës përmbarimore në rast të vonesave të mëdha; |
| 11 | Kontesti i rastit gjyqësor me operatorin që IL ka pasur kontratë për shitjen e energjisë elektrike mund të rrezikoj likuiditetin. | ☐ Sipas të gjitha gjasave<br>☐ I mundshëm<br>☒ Mesatar<br>☐ Vështirë se<br>☐ Rrallë | ☐ Serioz / Fatal<br>☒ Madhor<br>☐ Mesatar<br>☐ I vogël<br>☐ I Papërfillshëm | N/A | N/A | Menaxhim i kujdesëshëm financiar |

Masat e ndërmarra

| Nr. | **Lista e Rreziqeve 2025** | **Dëshmitë mbështetëse (referenca dokumenteve)** |
|---|---|---|
| 1 | | |
| 2 | | |

*RAPORT I AUDITIMEVE TE BRENDSHME 2025*

## *1. Hyrje*

Ky raport vjetor paraqet aktivitetet e Njësisë së Auditimit të Brendshëm për vitin 2025. Raporti përmbledh auditimet e realizuara, dhe rekomandimet e dhëna, si dhe kontribuon në forcimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, menaxhimit të rrezikut dhe qeverisjes, duke rritur transparencën dhe llogaridhënien brenda Ndërmarrjes.

## *2. Rekomandimet dhe Monitorimi i Tyre*

- Numri i auditimeve të planifikuara sipas planit vjetor: 6(5 +1 me kërkes të KA)
- Auditimet të realizuara me kërkesë të Komisionit të Auditimit(KA): 1
- Numri i auditimeve të realizuara: 6
- Auditime sipas planit vjetor dhe kërkesës së Ministrisë së Ekonomisë për verifikimin e rregullsisë së shpenzimeve: NA
- Auditime të projekteve Investime Kapitale të financuara nga Ministria e Ekonomisë: NA
- Numri i rekomandimeve të dhëna: 10
- Përqindja e rekomandimeve të zbatuara: 90% të dhënat referohen në muajin Dhjetor 2025, pasi ne Qershor nuk është testuar zbatimi i rekomandimeve, pasi qe në Ndërmarrje duhet te priten afate me të gjata kohore për implementim te rekomandimeve.
- Rekomandimet në proces zbatimi: Nuk ka rekomandime ne proces zbatimi.
- Përqindja e rekomandimeve të pazbatuara: 10% të dhënat referohen në muajin Dhjetor 2025, pasi qe auditimi i fundit i përfunduar është në Dhjetor 2025 dhe i njëjti nuk pas mundësi me fillu zbatimin.
- Ndikimi: përmirësim i menaxhimit dhe transparencës, rritje e llogaridhënies dhe besueshmërisë, rritje e efikasitetit në zbatimin e politikave.
- Auditime të realizuara por të pamiratuara përfshirë dhe planin vjetor 2026: NA

Të gjitha auditimet e vitit 2025 qe kanë qenë të planifikuara janë realizuar nga Njësia e Auditimit të Brendshëm(NjAB) dhe Raporti gjashtë mujor dhe vjetor është dorëzuar ne MFPT sipas afateve ligjore, gjithashtu është miratuar edhe "Plani Vjetor" NjAB për NPH :"Iber Lepenc" Sh.A, për vitin 2026.

## *3. Përfundime*

Auditimet e realizuara kanë kontribuar në identifikimin e fushave për përmirësim dhe në dhënien e rekomandimeve për forcimin e kontrollit të brendshëm, menaxhimin efektiv të resurseve dhe përmisimin e proceseve të Ndërmarrjes.

## *4. Aneks – Tabela e Auditimeve të Realizuara*

Gjatë vitit 2025 janë planifikuar dhe realizuar gjithsejtë gjashtë(6) auditime sipas Planit Vjetor të Auditimit, ku pesë(5) ishin me plan dhe një me kërkesë të Komisionit të Auditimit(edhe ky ishte i planifikuar). Për secilin auditim të përfunduar janë pregaditur Raporte me të gjeturat dhe rekomandimet përkatese.

| Nr. | Tema e Auditimit | Rekomandimet | Lloji i auditimit |
|---|---|---|---|
| 1 | Llogarive e arkëtueshme nga shitja e ujit | *1.Në formë të një letër-kujtese së paku në periudha tremujore të dërgohet si paralajmërim te KRU "Mitrovica" Sh.A gjendja e kërkesave nga llogaritë e arkëtueshme* | Me Plan |
| 2 | Përmbajtja e dosjeve të personelit | *-Nuk ka të gjetura* | Me Plan |
| 3 | Shpenzimet e bufesë | *1. Të harmonizohen çmimet e pijeve në bufe me çmimet e furnizimit sipas kontratës*<br>*2. Regjistrimi i bufesë në fund vit të barazohet me saldon e kartelës së bufesë të pranuar nga kontabiliteti dhe të çregjistrohet malli i skaduar sipas raportit të komisionit.*<br>*3. Të respektohet neni 16 i rregullores së brendshme nr.01.2024 për kompensimet jashtë pagës bazë dhe reprezentacionit* | Me Plan |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 4 | Shfrytëzimi I pushimeve vjetore nga punonjësit | *1.Menaxhmenti duhet të sigurojë qe të ketë përputhje në mes të raporteve të vijueshmërisë me raportet e orëve të punës.*<br>*2. Menaxhmenti të siguroj që pushimet të jenë në harmoni të plotë me legjislacionin në fuqi duke ofruar dëshmi formale.* | Me Plan |
| 5 | Auditim me kërkes të Komisionit të Auditimit(KA) Procedurat e prokurimit | *1. Zyra e Prokurimit të përpiloi Planin e Prokurimit bazuar në Planin e Biznesit të aprovuar nga BD si dhe njësia e këkesës mos të bëjë kërkesa për investime të paplanifikuara.*<br>*2. Menaxhmenti duhet të sigurojë koordinimin e njësisë së kërkesave me Zyren e Prokurimit me qëllim të harmonizimit të specifikave bazuar në Ligjin e prokurimit publik si dhe për të siguruar transparencë, përgjegjshmëri dhe përputhje me ligjet, rregullator dhe udhëzimet në fuqi.*<br>*3. Të përcaktohet dhe zbatohet detyrimisht praktika që çdo dokument zyrtar të përmbajë datë dhe nënshkrim, si dhe të vendosen mekanizma kontrolli që dokumentet pa këto elemente të mos pranohen apo përdoren në proceset e prokurimit* | Me Plan |
| 6 | Shitja e energjisë elektrike | *1.Menaxhmenti i Ndërmarrjes duhet të hartojë një rregullore të plotë për procesin e shitjes së energjisë elektrike, e cila do të përfshijë të gjitha fazat e procesit nga prodhimi, faturimi, arkëtimi si dhe përgjegjësitë, autorizimet dhe kontrollet përkatëse.* | Me Plan |

# RAPORTE TË AUDITIMEVE 2025

## HYRJE

Në përputhje me kërkesën e NJPMNP-së, në cilësinë e Aksionarit, dhe duke u mbështetur në dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Kodin e Etikës dhe Qeverisjes Korporative, si dhe legjislacionin për kontrollin e brendshëm financiar publik, ky raport paraqet vlerësimin e rreziqeve të larta për vitin 2025. Të dhënat e auditimit të jashtëm për vitin 2025 mbi rreziqet e larta:

| RAPORT I AUDITORIT TË JASHTËM | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Përshkrimi i konstatimeve | Gjetjet | Rekomandimet | Mashtrimi | Mundësia e mashtrimit | Ndikimi | Rrezik i lartë | Mundësia e mashtrimit | Ndikimi |
| Mungesa e përfshirjes së pasurive përkatësisht klasa e tokave në regjistrin e pasurive | 1 | 1 | X | ☐ Sipas të gjitha gjasave<br>☐ I mundshëm<br>☒ Mesatar<br>☐ Vështirë se<br>☐ Rrallë | ☐ Serioz / Fatal<br>☒ Madhor<br>☐ Mesatar<br>☐ I vogël<br>☐ I Papërfillshëm | Rrezik financiar / rrezik i raportimit financiar | ☐ Sipas të gjitha gjasave<br>☐ I mundshëm<br>☒ Mesatar<br>☐ Vështirë se<br>☐ Rrallë | ☐ Serioz / Fatal<br>☒ Madhor<br>☐ Mesatar<br>☐ I vogël<br>☐ I Papërfillshëm |
| Mos rivlerësimi i pasurive të ndërmarrjes që nga viti 2007. | 1 | 1 | X | ☐ Sipas të gjitha gjasave<br>☒ I mundshëm<br>☐ Mesatar<br>☐ Vështirë se<br>☐ Rrallë | ☐ Serioz / Fatal<br>☒ Madhor<br>☐ Mesatar<br>☐ I vogël<br>☐ I Papërfillshëm | Rrezik financiar / rrezik i raportimit financiar | ☐ Sipas të gjitha gjasave<br>☐ I mundshëm<br>☒ Mesatar<br>☐ Vështirë se<br>☐ Rrallë | ☐ Serioz / Fatal<br>☒ Madhor<br>☐ Mesatar<br>☐ I vogël<br>☐ I Papërfillshëm |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Prezantimi jo i saktë i Rezervës së Rivlerësimit | 1 | 1 | X | ☒ Sipas të gjitha gjasave<br>☐ I mundshëm<br>☐ Mesatar<br>☐ Vështirë se<br>☐ Rrallë | ☐ Serioz / Fatal<br>☒ Madhor<br>☐ Mesatar<br>☐ I vogël<br>☐ I Papërfillshëm | Rrezik financiar / Rrezik Ligjor përputhshmërie | ☐ Sipas të gjitha gjasave<br>☒ I mundshëm<br>☐ Mesatar<br>☐ Vështirë se<br>☒ Rrallë | ☐ Serioz / Fatal<br>☒ Madhor<br>☐ Mesatar<br>☐ I vogël<br>☐ I Papërfillshëm |
| Zhvlerësimi i pasurive jo sipas kërkesave të standardeve | 1 | 1 | X | ☒ Sipas të gjitha gjasave<br>☐ I mundshëm<br>☐ Mesatar<br>☐ Vështirë se<br>☐ Rrallë | ☐ Serioz / Fatal<br>☐ Madhor<br>☒ Mesatar<br>☐ I vogël<br>☐ I Papërfillshëm | Rrezik financiar / Rrezik Ligjor përputhshmërie | ☐ Sipas të gjitha gjasave<br>☒ I mundshëm<br>☐ Mesatar<br>☐ Vështirë se<br>☒ Rrallë | ☐ Serioz / Fatal<br>☐ Madhor<br>☒ Mesatar<br>☐ I vogël<br>☐ I Papërfillshëm |

Të dhënat e auditimit të brendshëm për vitin 2025 mbi rreziqet e larta:

| RAPORTE TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Departamenti | Gjetjet | Rekomandimet | Mashtrimi | Mundësia e mashtrimit | Ndikimi | Rrezik i lartë | Mundësia e mashtrimit | Ndikimi |
| Departamenti i Financave / Kontributet Pensionale | 2 | 2 | X | ☐ Sipas të gjitha gjasave<br>☐ I mundshëm<br>☐ Mesatar<br>☐ Vështirë se<br>☐ Rrallë | ☐ Serioz / Fatal<br>☐ Madhor<br>☐ Mesatar<br>☐ I vogël<br>☐ I Papërfillshëm | Financiar | ☐ Sipas të gjitha gjasave<br>☐ I mundshëm<br>☐ Mesatar<br>☐ Vështirë se<br>☒ Rrallë | ☐ Serioz / Fatal<br>☒ Madhor<br>☐ Mesatar<br>☐ I vogël<br>☐ I Papërfillshëm |

Përfundim:

Raporti i vlersimit të rrezikut për vitin 2025 thekson vetëm fushat me rrezik të lartë, duke përfshirë mashtrimet e mundshme, ndikimet financiare dhe fiskale, si dhe ekspozimet operative që kanë rëndësi madhore për ndërmarrjen. Dokumenti siguron transparencë dhe llogaridhënie, duke ofruar një pasqyrë të qartë mbi rreziqet kryesore të identifikuara.